


PANDËSHKUESHMËRIA

në procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve


Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e **Këshillit të Lartë të Drejtësisë**




Procesi disiplinor ndaj gjyqtarëve




Rezultati i procedimeve disiplinore Prill-Tetor 2014 (gjithsej 20 procedime)




Masat disiplinore të propozuara në periudhë Prill-Tetor 2014, sipas Ministrit të Drejtësisë




Çfarë ka ndodhur me propozimet për “shkarkim nga detyra”?






Çfarë ka ndodhur me propozimet për “vërejtje me paralajmërim”?




Çfarë ka ndodhur me propozimet për “dërgim 1 - 2 vjet në një gjykatë tjetër”?



-  Ndryshim nga MD në "vërejtje me paralajmërim"
-  Ndryshim nga MD në "vërejtje"
-  Pushim nga MD

Ecuria e ankimeve

Nr.	Gjyqtari i ankuar	Vendimi i KLD	Masa e dhënë	Ecuria e procesit
1	E.Gj.	44/2014	Transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për 2 vjet	Gjykata Administrative e Apelit ka rrezuar padinë. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit e ka dërguar paraprakisht çështjen për interpretim në Gjykatën Kushtetuese.
2	A.Ç.	45/2014	Sharkim nga detyra	Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë prishur vendimin e KLD-së dhe kanë vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në KLD.
3	E.H.	46/2014	Vërejtje me paralajmërim	Gjykata Administrative e Apelit ka rrezuar padinë. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.
4	N.P.	47/2014	Vërejtje me paralajmërim	Gjykata Administrative e Apelit ka rrezuar padinë. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.
5	E.T.	48/2014	Vërejtje me paralajmërim	Gjykata Administrative e Apelit ka rrezuar padinë.
6	L.H.	62/2014	Vërejtje	Gjykata Administrative e Apelit ka rrezuar padinë. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.
7	A.Y.	88/2014	Vërejtje me paralajmërim	Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar padinë dhe ka shfuqizuar vendimin e KLD. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.
8	B.M.	99/2014	Vërejtje me paralajmërim	Në pritje për shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.
9	I.P.	104/2014	Vërejtje me paralajmërim	Në pritje për shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.
10	H.Ç.	105/2014	Vërejtje me paralajmërim	Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar padinë dhe ka shfuqizuar vendimin e KLD. Çështja është në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.



Konkluzione

Shkaqet e evidentuara

1. Kompetenca ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë ka mundësuar që:
 - në **5 raste**, mosveprimi i këtij institucioni të mbyllë cdo rrugë tjetër për procedimin disiplinor të gjyqtarëve, bazuar në gjetjet e Inspektoriatit të KLD-së.
 - në **8 raste**, vullneti i këtij institucioni të transformojë ashpërsinë e ndëshkimit, duke e detyruar KLD-në të japë masa disiplinore më të lehta.
 - në **1 rast**, çështja të pushohet pa marrë asnjë vendim për masë disiplinore
 - në **2 raste**, mosveprimi për kërkimin e një mase më të butë, pas rrëzimit nga KLD të propozimit të parë, për mungesë proporcionaliteti, ka mbyllur cdo mundësi për ndëshkimin e gjyqtarëve me një masë më të butë.
 - në **77% të rasteve** të përcjella nga Ministri i Brendshëm nuk rezulton të jetë ndërmarrë një veprim konkret. Tashmë afati ka skaduar. Në KLD është dërguar **vetëm 1 rast**, ose **1.5%**.

Konkluzione

Shkaqet e evidentuara

2. Mungesa e një vije të qartë demarkacioni në arsyetimin e ndarjes midis shkeljeve të rënda dhe atyre të lehta nga KLD, i ka dhënë këtij organi një diskrecion tepër të gjerë për të marrë vendime pa i shoqëruar me arsyetim mjaftueshëm. Kështu:

- në **3 raste**, Ministri i Drejtësisë është detyruar të ndryshojë propozimin e masës disiplinore, pas rrëzimit nga KLD të masës së propozuar fillimisht.

3. Pengesa e paarsyeshme nga ILDKPKI (në një rast në të kaluarën) për të aksesuar deklaratat e pasurisë së gjyqtarëve, pasuar me mosveprimin pa shkak të arsyeshëm nga KLD ka bërë të mundur që:

- në **3 raste** me peshë specifike të rëndë, hetimi të mos kryhet duke shkaktuar mungesë artificiale provash, me pasojë rrëzimin e çështjeve. Në këtë rast evidentohet se edhe nga Ministri i Drejtësisë nuk janë bërë përpjekje për të siguruar provat e plota, të cilat u siguruan nga Res Publica në një test të kryer, ku u provua se deklaratat e pasurisë ishin lehtësisht të aksesueshme edhe nga një OJF e thjeshtë.

Konkluzione

Shkaqet e evidentuara

4. Përdorimi i analogjisë së gabuar (Kodi i Procedurës Civile në vend të Kodit të Procedurës Administrative) nga KLD, i ka dhënë këtij organi që:
 - në **1 rast** të pushojë procedimin disiplinor, pa marrë asnjë masë ndaj gjyqtarit, megjithëse ishin evidentuar shkelje nga Inspektoriati i KLD-së

5. Ekzistenca e dy inspektoriateve të ndarë ka sjellë pasoja të ndryshme, por me interes për këtë studim paraqitet:
 - **1 rast**, kur shkeljet kanë qenë të lehta dhe jo të përshtatshme për një masë disiplinore, por në këtë rast nuk është dhënë masa “tërheqje e vëmendjes” e cila bëhet edhe pjesë e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit.

Rekomandim #1

**Nisma për procedimin disiplinor të mos jetë
ekskluzivitet i Ministrit të Drejtësisë**

Rekomandim #2

Nëse afati 1-vjeçar nuk ka skaduar ende, të nisë procesi i verifikimit të rasteve të lëna pezull, për shkak të mosverifikimit pa shkak ligjor të deklaratave të pasurisë

Rekomandim #3

Në rast tërheqjeje nga autoriteti që nis procedimin disiplinor, KLD të mos pushojë procedimin

Rekomandim #4

Inspektoriati i KLD dhe inspektoriati i MD të bashkohen në një strukturë të vetme nën varësinë KLD

Rekomandim #5

Të bëhen publikë raportet e zbatimit të memorandumeve të mirëkuptimit

Rekomandim #6

Në rastet kur KLD nuk pranon kërkesën për procedimin disiplinor të gjyqtarëve për shkak se shkelja është shumë e lehtë dhe procedimi ka nisur në bazën e një inspektimit të Inspektoriatit të Ministrisë së Drejtësisë, ky i fundit të referojë çështjen tek Inspektoriat i KLD-së, për të ekzekutuar masat e posaçme në të tilla raste

Rekomandim #7

Afati 1 vjeçar, i llogaritur nga momenti i komunikimit të gjetjeve të shkeljeve, brenda të cilit Ministri i Drejtësisë duhet të nisë procedimin disiplinor, duhet të shkurtohet

Rekomandim #8

Të rishikohet masa disiplinore “dërgim në një gjykatë tjetër për 1-2 vjet”, pasi kjo masë penalizon jo vetëm gjyqtarin, por edhe popullsinë e rrethit ku dërgohet gjyqtari

Rekomandim #9

Moszbatimi i vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, të mos ndëshkohet domosdoshmërisht me shkarkim nga detyra, por me një masë më të butë